

# AKT - T H E M E L I M I

## "MIKI-KONSTRUKSION" SH.K.P. MALSI E MADHE

### Neni 1

Eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K. me seline e saj ne qytetin **Koplik** ne shtepine e z. **Gjeto DUKAJ** i biri i Mirashit dhe i Dranes i datelindjes 1966 lindur ne Lepushe dhe banues ne **Koplik** me leternjoftim personal **UG Nr: 440172** , dhe adrese te plote: **Koplik-MALSI E MADHE**.

Shoqeria eshte krijuar me kontributin e z.**Gjeto DUKAJ** me nje kapital themeltar prej 100 000 lek.

### Neni 2

Fitimi i realizuar do ti mbetet ortakut te vetem zotit.**Gjeto DUKAJ**

### Neni 3

Kjo shoqeri munde te hape dege dhe agjensi te tjera ne **SHQIPERI** dhe jashte saj ne zgjerimin e aktivitetit te saj dhe ne baze te vendimeve qe merr administratori dhe ortaku i vetem.

### Neni 4

Objekti i shoqerise . "**MIKI-KONSTRUKSION**" SH.P.K. **KOPLIK** eshte te ushtroje aktivitet privat ne sferen e zbatimit ne fushen e ndertimeve civile -industriale, ushtarake ,banesa ,hotele, objekte kulti, etj.

Projektme ne fushen hidroteknike dhe ndertime civilo-industriale.

Zbatime te objekteve ne fushen hidroteknike.Prodhimi ,perpunimi i materialeve te ndertimit, tregtimi i tyre dhe i madhrave dhe i materialeve te tjera te industrise se lehte dhe te rende dhe ushqimore me pakice dhe shumice, transportimi , magazinimi dhe shperndarja e madhrave dhe te materialeve te tjera, importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te madhrave dhe te materialeve, investime ne fushen e ndertimit komunikacion, tregti sherbimi etj, kafene ,restorante,hotele dhe diskoteka,salla lojrash, kende sportive etj.

Perfaqesime,ndermjetsime dhe koperime per aktivitete te ndryshme tregtare dhe prodhuese sherbime dhe ne fushen e tranzitimit te madhrave dhe te sherbimeve, organizimi dhe pajisja e panaireve dhe e ekspozitave sherbimesh dhe reklame dhe marketingu ne sferen e asistences teknike eksperte vendas e te huaj per kryerjen e studimeve tersore teknike financiare etj.

### Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne10 vjete me te drejte ripertritjete, por ajo munde te pushoje aktivitetin e saj edhe perpara ketij afati ne rastet e percaktuara ne statutin e shoqerise.



**Neni 6**

Administratori dhe ortaku i vetem i "MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K. do te jete z. **Gjeto DUKAJ** i cili perfaqeson shoqerine ne marrdhenie me te tretet por ajo munde te perfaqesohet dhe nga persona te tjere te paisur me prokure te posaçme.

**Neni 7**

Shoqeria vepron ne baze te legjislacionit Shqiptar dhe standarteve shteterore.

**Neni 8**

Persa nuk trajtohet ne kete **AKT-THEMELIMI** i lihet mundesia administratorit e ortakut te vetem per ta shtuar me vone ate. Si lexohet akt -themelimi nenshkruhet rregullisht nga administratori dhe ortaku i vetem.

**ADMINISTRATORI DHE ORTAKU I VETEM**  
**"MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K.**  
**MALSI E MADHE**

**Ing: Gjeto DUKAJ**



Republika e Shqiperise  
Zyra e Noterise Shkoder


Nr. rep. 954  
Nr. Kol. 338

Autentifikim nenskrimi

Ne Shkoder sot me date 26.4.1996 ( nentedhjete e gjashte) dite e Prente ne Zyren e Noterise Shkoder dhe para meje Noteres Lumturi S.Hoxha u paraqit persojalishte Gjeto Duka landur dhe banues ne Shkoder. Per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leternjoftimit te tije personal dhe pasi u binda se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligja me kerkes te tije i vertetova nenskrimet e deklarimeve te me sipërme.



Notere  
Lumturi S.Hoxha /



# STATUTI

## " MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K. MALSI E MADHE

### FORMIMI.

#### Neni 1

Shoqeria tregtare "MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K. Koplik-MALSI E MADHE drejtohet nga ortakut i vetem z. **Gjeto DUKAJ** i biri i Mirashit dhe i Dranes i datelindjes 1966 lindur ne Lepushe dhebanues ne Koplike te Rrethit **Malsi e Madhe** me leter njoftim personal **UG Nr:440172**,dhe adrese te plote:**Koplik-MALSI E MADHE**. Ajo vepron si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

### SELIA

#### Neni 2

Selia e "MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K. do te jete ne qytetin e Koplikut ne banesen private te z.**Gjeto DUKAJ**, me adrese :**Koplik-MALSI E MADHE**. SH.P.K. munde te hape filiale dhe dege te tjera, ne teritorin e **REPUBLIKES SE SHQIPERISE** si dhe jashte shtetit ne perputhje me legjislacionin.

### KOHEZGJATJA

#### Neni 3

Kohezgjatje e veprimtarise se "MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K.do te jete deri ne 10 vjete me te drejte riperteritje .Ajo munde te pushoje veprimtarine e saj ekonomike edhe perpara ketij afati ne rastet e caktuara ne kete statut.

### OBJEKTI

#### Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :te ushtroje veprimtarine e saj ne sferen e ndertimit dhe aktivitete te tjera qe lidhe direkt me keto fusha si me poshte:

**a**-Zbatim ne fushen e ndertimeve civile, industriale,ushtarake,banesa, hotele,objekte kulti, rruge, infrastrukture etj.

**b**-Prodhimi, perpunimi i materialeve te ndertimit , tregtimi i tyre dhe i materialeve te tjera te industrise se rende dhe ushqimore me pakice dhe shumice , transportimin, magazinimin dhe shperndarjene madhrave dhe materialeve te tjera

**c**-Zbatime ne fushen e ndertimeve hidrotiknike te te gjitha llojeve.

**d**-Projektme ne fushen hidroteknike si dhe ne fushen e objekteve civile-industriale.

**e**-Importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te madhrave dhe materialeve te tjera.

**f**-Investime ne te gjitha fushat :ndertim, komunikacion, tregti, sherbime te tjera.

**g**-Krijimi i ambienteve shlodhese, hapja e lokaleve, kafeneve,restoranteve,hoteleve.



diskotekave, salla lojrash e qendra sportive etj.

**h**-Perfaqesime, ndermjetsime dhe koperime te ndryshme tregtare, prodhuese, sherbimesh dhe ne fushen e tranzitimit te madhrave dhe te sherbimeve.

**k**-Organizimi dhe pajisja e panairove dhe ekspozitave, sherbime reklame dhe marketingu.

**j**-Ne sferen e asistences teknike, eksperte vendas dhe te huaj per kryerjen e studimeve tersore tekniko-profesionale, financiare, marketingu etj, per zhvillimin e vete shoqerise.

#### Neni 5

SH.P.K. "MIKI-KONSTRUKSION" munde te ndryshoje emertimin e saj, seline, dhe objektin e vepritarise se saj, formen, te ndahet, te bashkohet apo te shperbehet sipas vendimeve te marra nga ortaku i vetem.

Ajo munde te siguroje ne siper marrjet e saj te ndryshme dhe pjesemarrjen ne shoqeri te tjera te huaja apo vendase, brenda vendit dhe jashte territorit te **REPUBLIKES SE SHQIPERISE** ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### **KAPITALI THEMELTAR**

#### Neni 6

Sh.P.K. "MIKI-KONSTRUKSION" ka nje kapital themeltare prej 100000 lekesh dhe eshte vene nga administratori dhe ortaku i vetem z. **Gjeto DUKAJ**. Kapitali themeltare i shoqerise munde te shtohet ne perputhje me dispozitat ne fuqi. Kapitali munde te transferohet ose munde te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ai munde te transferohet ne rruge trashigimie bashkeshortit, dhe pasardhesit, dhe paraardhesit munde te behen ortake te shoqerise nepermjete transferimit te pjesve te kapitalit themeltare.

### **FONDET E "MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K.**

#### Neni 7

SH.P.K. "MIKI-KONSTRUKSION" percakton fondet e meposhtme:

**a**-Fondi themeltare

**b**-Fondi rezerve

**c**-Fonde te tjera te cilat munde te jene te nevojshme per realizimin e veprimtarise se saj.

Masa e sejcilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohet nga administratori dhe ortaku i vetem .





## ORGANET DREJTUESE

### Neni 8

Organi me i larte i shoqerise eshte administratori dhe ortaku i vetem..Ai ka te drejte te vendose per pjesemarrjen e shoqerise ne shoqerite e tjera, te ndryshoje ose te plotesoje ne statutin , te vleresoje bilancet vjetore te vleresuara nga organi i tij financiar, percakton politiken ekonomike te Sh.P.K"**MIKI-KONSTRUKSION**", te caktoje administratore dhe te caktoje detyra, te vendose per shperndarjen e shoqerise.

### Neni 9

Pronar i vetem dhe administrator "**MIKI-KONSTRUKSION**" SH.P.K. eshte zoti. **Gjeto DUKAJ** i cili drejton veprimtarine ekonomike te saj, duke u mbeshtetur ne te drejten e tij te pronsise private dhe te mjeteve te investuara ne shoqeri

### Neni 10

SH.P.K "**MIKI-KONSTRUKSION**" vepron me te drejten e pronesise dhe merr persiper te drejta dhe detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontadiktore brenda kapitalit te saj. Administratori dhe ortaku i vetem ka te mbartur rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara me kapitalin e shoqerise.

Sh.P.K "**MIKI-KONSTRUKSION**" merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas normave te ketij statuti te cilat jane te detyrueshme per personat e emruar dhe te gjitha te punesuarit ne shoqeri.

### Neni 11

SH.P.K. "**MIKI-KONSTRUKSION**" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te ketij statuti si dhe ato te legjislacionit ne fuqi.

SH.P.K. "**MIKI-KONSTRUKSION**" -KOPLIK fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin si person juridik ne rregjistrin tregtare te gjykates se rrethit te **TIRANES** , ndersa e ushtron aktivitetin e saj ekonomik me rregjistrimin e saj ne organin tatimor te pushtetit lokal .

### Neni 12


SH.P.K. "**MIKI-KONSTRUKSION**" ka vulen e saj me permbajtje: "**MIKI-KONSTRUKSION**" SH.P.K. **MALSI E MADHE** (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar). Te drejten e perdorimit te vules e kane administratori dhe ortaku i vetem si dhe personat e autorizuar prej tij.

### Neni 13

Administratori dhe ortaku i vetem ne baze te vendimeve qe merr. Ai cakton punonjes te aktiviteve te ndryshme te cileve u cakton pagat dhe detyrimet .

### Neni 14

Administratori dhe ortaku i vetem i "**MIKI-KONSTRUKSION**" SH.P.K. dhe personat e caktuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e shoqerise, pa asnje kufizim dhe perjashtim, me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep, shprehimisht



administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise. Personat e caktuar prej administratorit e ortakut te vetem munde te kryejne vete veprimtarine ne emer te SH.P.K. ne marrdhenie me te tretet , ata veprojne ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat. Ata kane te drejte te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise.

SH.P.K .merr persiper detyrimet qe rrjedhjin nga aktet e personave te caktuar prej saj dhe kurre keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve , kur keto te fundit e dinin se akti i tyre e kalonte objektin e shoqerise , ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethana te dhena. Ato kane te drejte te bejne veprime prane te gjitha zyrave shteterore e private qe kane te bejne me garancite dhe veprimet ipotekore. Ne te tilla raste personi i caktuar (i autorizuar) njofton dhe jep llogari perpara administratorit dhe ortakut te vetem .Ata kryejne veprimtari per blerjen e shitjen e pasurise ne emer te shoqerise , te negocioje dhe te hyje ne marrdhenie me shoqerite te tjera (vendase dhe te huaja) brenda dhe jashte vendit.

## **MARRDHENIET E PUNESIMIT.**

### **Neni 15**

Marrdheniet e punes rregullohen sipas kontrates se punes .Mosmarrveshjet zgjidhen me mirekuptim , ne raste te kundert i drejtohen gjykates per zgjidhje. Ne raste se i punesuari eshte person juridik i huaj mosmarrveshjet zgjidhen nga organet qe percaktohen ne kontraten e punes.

### **Neni 16**

Te gjitha te punesuarit ne shoqerine jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise, sekret pune paraqesin shkresat e materiale, paraqesin aktet te cilat me ligje dhe dispozita te vecanta si dhe vendimet e nxjerra administratori dhe ortaku i vetem i shoqerise jane te shpallur sekret pune , te dhenat informative , bilancet , planet dhe informacionet , mbi politiken e shoqerise qe u jep organeve te miratuara dhe te firmosura nga administratori dhe ortaku i vetem i shoqerise.

## **PERFAQESIMI I SHOQERISE.**

### **Neni 17**

Perfaqesimi i SH.P.K. " MIKI-KONSTRUKSION" ne KOPLIK i perket administratorit dhe ortakut te vetem z.Gjeto DUKAJ dhe personave te autorizuar nga ai .Ata kane te drejte te perfaqesojne shoqerine edhe ne organet gjyqesore, e ne gjykimet te caktojne dhe te pushojne avokatet per ceshtjet ne gjykim.

### **Neni 18**

Administratori dhe ortaku i vetem mund te caktoje eksperte kontabel qe te kontrollojne aktivitetin financiar arken dhe rregjistrimin e veprimeve kontabel te shoqerise dhe pergatit raportin perkates , bilancin dhe te ardhurat.

### **Neni 19**

SH.P.K "MIKI-KONSTRUKSION" KOPLIK çel llogarine e saj rrjellese ne banken shteterore, veprimet ekonomike te shoqerise mbydhen me 31 dhjetor te çdo



viti. Ne funde te çdo periudhe nxirret bilanci kontabel qe miratohet nga eksperti ,administratori dhe ortaku i vetem.

Te ardhurat neto pas veçimit te fondeve te nevojshme i mbeten administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise e cila ndahet per zgjerimin e kapitalit te saj , fondeve te shoqerise administratorit dhe ortakut te vetem.

### **CMIMET**

#### **Neni 20**

Aktiviteti e saj SH.P.K "MIKI-KONSTRUKSION" KOPLIK do ta zhvilloje kundrejt çmimeve sipas kerkeses dhe ofertes , me perjashtim te rasteve qe jane te percaktuara me vendim qeverie.

### **SHPERBERJA E SHOQERISE.**

#### **Neni 21**

Shperberja e shoqerise munde te vije ne çdo kohe dhe per çdo lloj shkaku, si humbje kapitali, pa mundesi veprimtarie ose me vendim te administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise. Ne kete raste ai vendos per menytrat e likujdimit te shoqerise dhe caktojne nje ose me shume likujdatore.

### **DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

#### **Neni 22**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht me kete statut i referohet plotesimeve qe do i bejne ne baze te ligjeve. Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut behen ne te njejten menyre dhe procedure ne te cilen nxirret statuti. Statuti nenshkruhet rregullisht nga administratori i SH.P.K. "MIKI-KONSTRUKSION".

**ADMINISTRATORI DHE ORTAKU I VETEM I  
("MIKI-KONSTRUKSION" SH.P.K. MALSI E MADHE)**

**Ing: GJeto DUKAJ**

